



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**QENDRA KOMBËTARE E KINEMATOGRAFISË**  
**KRYETARI**

---

**VENDIM**

Nr. 364, Datë 23.08.2021

**“Për disa shtesa dhe ndryshime në  
Rregulloren e Qendrës Kombëtare të Kinematografisë nr. 155 Prot.,  
datë 24.04.2020, të ndryshuar”**

Në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 8096, datë 21.03.1996, “Për Kinematografinë”, i ndryshuar, pikën 4, të Nenit 5, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 602, datë 21.08.2003, “Statuti i Qendrës Kombëtare të Kinematografisë”, si dhe Rregullores së Qendrës Kombëtare të Kinematografisë, nr. 155 Prot., datë 24.04.2020, të ndryshuar me Vendimin nr. 223 Prot., datë 27.04.2021, si dhe në respektim të vendimeve të marra në takimet konsultative me kryetarët e shoqatave të kineastëve datë 14.06.2021, si dhe datë 16.08.2021,

**V E N D O S A:**

I. Në Rregulloren e Qendrës Kombëtare të Kinematografisë nr. 155 Prot., datë 24.04.2020, të ndryshuar me Vendimin nr. 223 Prot., datë 27.04.2021, dhe Vendimin nr. 304 Prot., datë 25.06.2021, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Nënepika A/2, e Nënkapitullit I, Kapitulli IV, Këshillat dhe Komisionet bëhet si më poshtë:

*“2. Anëtarët e KMP duhet të jenë personalitete të fushës së artit dhe kulturës, shtetas të huaj, të cilët janë vlerësuar për kontributin e tyre në kinematografi dhe që plotësojnë këto kriterë:*

- a- Të kenë realizuar jo më pak se tre filma artistikë, nga të cilët një të jetë pranuar në konkurim zyrtar në një festival kompetitiv (kategoria A);*
- b- Të mos kenë precedentë penalë;*
- c- Të kenë figurë të pastër etike.”*

2. Pas nënplikës A/2, të Nënkapitullit I, Kapitulli IV, Këshillat dhe Komisionet, shtohet nënepika A/2/1 dhe A/2/2, me këtë përmbajtje:

---

**Rr. “Aleksandër Moisiu”, Nr.77, Tiranë**

**Tel: ++355 42 378 004**

**E-mail: [info@nationalfilmcenter.gov.al](mailto:info@nationalfilmcenter.gov.al)**

**[www.nationalfilmcenter.gov.al](http://www.nationalfilmcenter.gov.al)**

*“2/1. Kandidaturat për anëtarë të KMP me shtetësi shqiptare, duhet të personalitete të fushës së artit dhe kulturës, të cilët janë vlerësuar për kontributin e tyre në kinematografi dhe që plotësojnë këto kritere:*

- a- Të ketë realizuar jo më pak se dy filma artistikë, nga të cilët të paktën njëri të ketë marrë pjesë në festivale të rëndësishme ndërkombëtare filmi;*
- b- Të mos kenë precedentë penalë;*
- c- Të kenë figurë të pastër etike.”.*

*2/2. Shoqatat e kineastëve kanë të drejtë të propozojnë deri në dy kandidatura shtetas shqiptarë, të cilat në rast se plotësojnë kriteret, do t'i nënshtrohen votimit.”.*

3. Pas nënpikës 11, të pikës C/1 të Nënkapitullit I, Kapitulli IV, Këshillat dhe Komisionet shtohet pika 11/1 dhe 11/2, me këtë përmbajtje:

*“11/1. Pas përfundimit të votimit, në rast se konstatohen kandidatë me numër të barabartë pikësh një burrë dhe një grua, do të konsiderohet fituese kandidatja grua.*

*11/2. Pas përfundimit të votimit, në rast se konstatohen kandidatë me numër të barabartë pikësh dy burra, ose dy gra, atëherë do të bëhet rivotim vetëm për anëtarët/et me pikë të barabarta. Votimi do të qëndrojë i hapur 5 (pesë) ditë kalendarike.”.*

II. Ky vendim hyn në fuqi datën e nënshkrimit dhe bëhet pjesë e Rregullores së Qendrës Kombëtare të Kinematografisë nr. 155 Prot., datë 24.04.2020, të ndryshuar me Vendimin nr. 223 Prot., datë 27.04.2021, dhe me Vendimin nr. 304 Prot., datë 25.06.2021.

III. Ngarkohet Drejtoria e Projekteve të bëjë njoftimin përkatës në faqen zyrtare të internetit të Qendrës Kombëtare të Kinematografisë, si dhe në rrjetet sociale për ndryshimet përkatëse.

**KRYETARI**

**Eduart MAKRI**